

KONTABILITETI

Mësimdhënës: Ylber PREKAZI

Prezentim dhe hyrje në kontabilitet

- ▶ *Pse e mësojmë kontabilitetin?*
- ▶ *Pse është i rëndësishëm kontabiliteti? Kush e përdorë kontabilitetin?*
- ▶ *Kontabiliteti si profesion dhe/apo si shkencë!*

Metodologjia e punës

- ▶ *Metodat mësimore (të ligjerimit dhe ushtrimeve)*
- ▶ *Metodat e vlerësimit*

Hapi 1: Përcaktoni përse lëndë e kontabilitetit është e rëndësishme për ju.

- ▶ Së pari, mendoni përse po e bëni këtë lëndë. Cilat janë qëllimet tuaja? A ju intereson me të vërtetë kjo lëndë? A keni motivim të fortë për të mësuar mbi kontabilitetin? Mbase në listën tuaj të karrierrës kontabilisti vjen menjëherë në fund. Mbase synimi juaj është të bëni shumë para. Ose, mbase vini në universitet për të kaluar kohën derisa të trashëgoni pasurinë e familjes. Në çdo rast kjo lëndë është hartuar për ju. Një nga mënyrat më të sigurta për të pasur 1 milion dollarë është që të filloni me dhjetë milion dhe të mos dini asgjë nga kontabiliteti dhe drejtimi i biznesit. Nëse ju nuk trashëgoni asnjë pasuri, ju nuk do të bëheni i pasur pa ditur të flisni gjuhën e biznesit. **Kontabiliteti është gjuha e biznesit!** Mbase ju dëshironi të filloni një punë më të mirë, dëshironi që të jeni kontabilist. Shumë mirë! Kjo lëndë ndoshta disa nuk do ti bëje kontabilist. Ajo do t'ju ndihmojë që të kuptoni disa nga "ritualet mistike" të kontabilitetit që jokontabilistëve shpesh u duken të ngatërruara. Çfarëdo lloj pozite drejtimi do të keni në ndonjë organizatë, të jini të sigurtë që do të keni punë me kontabilistët dhe me informacionin kontabël. Ju duhet ta dini se ata mund të kenë një ndikim të madh në jetën tuaj. Shumë organizata e përdorin informacionin kontabël për të vlerësuar punonjësit e tyre për pagat dhe në vendimet për ngritjen e punonjësve në përgjegjësi. Ju duhet të kuptoni sesi ta interpretoni këtë informacion. Ju mbase mund të kuptoni se kontabiliteti nuk është ai që mendoni. Pavarësisht nga fakti, nëse ju do ta doni apo urreni kontabilitetin, vendosni se ajo çka do të merrni nga kjo lëndë do të jetë e dobishme për ju.

Hapi 2: Zbuloni atë që pedagogu juaj pret nga ju për këtë lëndë.

- ▶ Më pas verifikojeni këtë me pedagogun tuaj. Nëse jeni me fat, pedagogu juaj do të jetë i ndjeshëm, i dashur, i kujdesshëm, me sens humori, i shkathët, i pëlqen që ti mësojë të tjerët dhe dëshiron që ju të dilni mirë në kurs. Nëse pedagogu juaj është normal (dhe më pak i përsosur), mbani mend, **se pedagogu mbetet pedagog**. Dhe si pedagog, ai ka pushtet mbi jetën tuaj. Kështu që, zbuloni se çfarë pret prej jush. Cilat janë qëllimet e tij për lëndën? Çfarë dëshiron që ju të dini ose të jeni të aftë të bëni pasi të përfundoni lëndën? Mbase ai do t'ju tregojë (shenjë e mirë), por nëse se bën, pyeteni. Ju duhet të thoni: "Profesor Cilido-qoftë-emri juaj (do të ishte më mirë që të përdorej emri i duhur), Çfarë është e pakëndshme në këtë lëndë?" ky është një zhargon edukimi për "cilat janë qëllimet e kësaj lënde"? Kjo mund të tërheqë vëmendjen, dhe ti japë një ose dy minuta për tu menduar. Ju mbase mund të prisni deri në takimin tjetër të klasës për të marrë përgjigjen tuaj. Sigurohuni që ju dhe pedagogu juaj të kuptoni qëllimet e njëri-tjetrit. Disa pedagogë kontabiliteti presin që të gjithë studentët të bëhen kontabilistë. Dhe kjo do të ishte gje e mire. Por ne jete jo cdo gje shkone ashtu sic e mendon petagogu, ashtu sic mund te jete deshira e tij.

Hapi 3: Zbuloni se si do të vlerësoheni.

- ▶ Tani, zbuloni se si do të vlerësoheni. Si teston pedagogu juaj? A është ai tip i vështirë i llojit: Cila është fjala e treta në rreshtin e peste në faqen 211?” Ose, a shikon ai të përgjithshmen, me anë të pyetjeve: “Shpjegoni sesi kontabiliteti ishte instrument në negocimin e traktatit të treta të Versajës në 1623”. A përpiqet ai për hamendësime, ose a janë përgjigjet e shkurtra pikat e tij të dobëta? Cilado qoftë metoda, ju duhet të dini se çfarë pritet nga ju dhe sesi këto pritje kalohen në nota. Nganjëherë do të gjeni ndonjë pedagog ku pritet të mos jenë të njëjta me mënyrën sesi ai teston dhe vlerëson. Prandaj ju duhet të kuptoni si pritet e pedagogut dhe vlerësimet. Nëse ato nuk duket se janë të qëndrueshme, atëherë duhet të përcaktoni se çfarë pret pedagogu në të vërtetë.

Hapi 4: Mësoni atë që është e rëndësishme.

- ▶ Zbuloni se çfarë ju duhet që të përmbushni qëllimet tuaja dhe pritjet e pedagogëve. Një mësim i madh që ju duhet të mësoni, nëse nuk e keni bërë, është “çfarë merrni nga kontabiliteti (dhe pothuajse çdo gjë tjetër) varet nga ajo që ju sillin në të”. Qëndrimi juaj është i rëndësishëm. Nëse vendosni se diçka ia vlen të mësohet, **ju do të gjeni mënyrën për ta mësuar atë**. Jo se ju duhet ta mësoni atë, por se ju dëshironi ta bëni. **“Dëshiroj” është pjesa më e madhe e të punuarit në mënyrë të zgjuar**. Dëshira për të mësuar do të bëjë një rrugë të gjatë duke ju ndihmuar të merrni rezultate të mira. Fatkeqësisht, ajo nuk do të jetë e mjaftueshme derisa ajo që ju dëshironi të mësoni të jetë gjithashtu ajo që pedagogu juaj dëshiron që ju të mësoni. Prandaj, duhet të siguroheni që ju dhe pedagogu juaj të jeni në të njëjtën gjatësi vale. Nëse nuk jeni atëherë flisni me njërit tjetrin. Zbuloni përse pedagogu juaj ka një pikëpamje tjetër. Ju mund të ndryshoni mendimin tuaj mbi atë që është e rëndësishme. Përcaktoni sesi të përqëndroni përpjekjet tuaja. Jo gjithçka në këtë libër ose leksion ka të njëjtën rëndësi. Përqëndrohuni në atë që është më e rëndësishme për ju dhe pedagogun tuaj.

Hapi 5: Komunikoni me pedagogun tuaj.

Përpiquni të kujtoni se pedagogu juaj është një person. Edhe autorët e një libri janë njerëz. Ne kemi gra, fëmijë dhe miq. Shumica e pedagogëve dëshirojnë me të vërtetë që ju të ecni përpara, por ne kemi nevojë për ndihmën tuaj. Pedagogët nuk dinë gjithçka. Në veçanti, ne nuk mund të lexojmë mendjen tuaj. Ju duhet të lejoni pedagogun tuaj të dijë nëse keni ndonjë problem për të kuptuar materialin që ju prisni për të mësuar, duke zbuluar atë që pedagogu pret prej jush, ose të zbuloni sesi të përgatiteni për testet dhe detyrat e tjera. Flisni me pedagogun tuaj mbi problemet që keni me këtë lëndë. Mbani parasysh se pedagogu është qenie njerëzore.

Ky është fakulteti juaj.Të punuarit me zgjuarsi nënkupton të përcaktoni se çfarë është e rëndësishme dhe të përqëndroni vëmendjen dhe përpjekjet tuaja në këto gjëra. Më pas, mos hiqni vëmendjen nga synimet tuaja. Nëse keni ndonjë problem përballuni me të. **Nëse nuk kuptoni diçka në klasë ose në libër, bëni pyetje.Mos kini frik te beni pyetje.Nëse keni frikë të bëni pyetje në klasë, mbani mend më mirë të dukesh i paditur në klasë,sesa të dukesh i paditur ne provim.** Nëse mendoni se nuk po kapni pikat kyçe, flisni me pedagogun tuaj. Nëse dëshironi të mësoni, ju mund ta bëni atë.Kjo është e gjitha. Përpiquni.Une mendojë se kështu lënda e kontabilitetit do të duket më e këndshme dhe eksperienca më fitimprurëse. Sigurisht, ju mund të përpiqeni të kryeni detyrat, të shkoni në klasë, të bëni gjumë dhe ushtrime të mjaftueshme, të hani mjaftueshëm dhe të studioni gjatë gjithë semestrit. Ato në përgjithësi ndihmojnë, ne ecurin tuaj,megjithëse janë të vështira.

Pse e mësojmë kontabilitetin?

► Sepse....

Pse është i rëndësishëm kontabiliteti? **Kush e përdorë kontabilitetin?**

- ▶ Roli i informacionit në drejtimin e një njësie ekonomike është pa diskutim shumë i madh;
- ▶ Të gjithë ata që kanë lidhje me jetën e një njësie ekonomike: si aksionarët, furnitorët, bankat, shteti, etj. Dëshitojnë të kenë një kuadër të përpiktë dhe të përditësuar të ecurisë së njësisë ekonomike;

Kontabiliteti si profesion dhe/apo si shkencë!

- ▶ **"Kontabiliteti** është arti i komunikimit të informacionit financiar të entitetit (njësisë) biznesor për përdoruesit siç janë aksionerët dhe menaxherët"
- ▶ **Në aspektin e teorisë shkencore** "Kontabiliteti përfaqëson shkencën dhe teknikën e vlerësimit, regjistrimit (kronologjik e sistematik), përmbledhjes dhe kontrollit të pasurisë dhe të të gjitha veprimeve ekonomiko-financiare të një njësie ekonomike (kompani ose institucion), me anë të metodave, parimeve e librave të posaçëm"
- ▶ **Kontabiliteti është profesion**, i cili arihet me kualifikim të lartë, përvojë, trajnime të vazhdueshme dhe zgjerim të njohurive.

LITERATURA

Literatura bazë:

- ▶ Sotiraq Dhamo, (2010) *Parimet bazë të kontabilitetit*;
- ▶ Rustem Asllanaj, (2010) *Kontabiliteti Financiar* (pjesa e parë);
- ▶ Ligjeratat e autorizuar nga ligjeruesi i lëndës (2015);

Literatura plotësuese:

- ▶ C. Warren, J. Reeve, J. Duchac, (2013), *Accounting*;
- ▶ Standardet kosovare të kontabilitetit (SKK)
- ▶ Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF)
- ▶ Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK)

Metodat e vlerësimit

Testet / Kollokviumet	Testi I	35 %
	Testi II	40 %
Detyrat nga njësit e caktuara		15 %
Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim:		10 %
Provimi		

2. Kuptimi dhe rëndësia e kontabilitetit si sistem informacioni.

- ▶ Vështrim mbi historinë e zhvillimit të kontabilitetit;
- ▶ Llojet e kontabilitetit;
- ▶ Koncepti dhe roli i kontabilitetit për subjektet ekonomike;
- ▶ Format e organizimit të njësive ekonomike të biznesit;
- ▶ Përdoruesit e informacionit kontabël;

3. Pasqyrat financiare dhe veprimet kontabël.

- ▶ Pasqyrat kryesore financiare;
- ▶ Ekuacioni bazik kontabël;
- ▶ Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare;
- ▶ Parimet dhe supozimet në ndërtimin e pasqyrave financiare;
- ▶ Ndikimi i transaksioneve në ekuacionin kontabël;

4. Procesi i regjistrimit kontabël. Sistemi i regjistrimit të dyfishtë.

- ▶ Sistemi i regjistrimit të dyfishtë si metodë bazë e kontabilitetit;
- ▶ Dokumentet burimore për regjistrimin e veprimeve;
- ▶ Llogaria (Konto). Ditari. Libri kryesor (i madh). Bilanci vërtetues;

5. Regjistrimet rregulluese.

- ▶ Periudha kontabël. Jetëgjatësia e biznesit;
- ▶ Baza monetare e kontabilitetit;
- ▶ Regjistrimet rregulluese. Shtyrjet dhe rritjet;
- ▶ Rëndësia e regjistrimeve rregulluese;

6. Kompletimi i ciklit kontabël.

- ▶ Llogaritë e përkohshme dhe të përhershme;
- ▶ Veprimet e mbylljes së llogarive;
- ▶ Bilanci vërtetues pas mbylljes;
- ▶ Përgaditja e pasqyrave financiare;

7. Kollokfiumi i parë

- ▶ Pyetje teorike
- ▶ Detyra

8. Kontabiliteti i firmave tregtare. Blerjet dhe shitjet.

- ▶ Blerjet e mallit dhe kontabiliteti i tyre. Kthimet dhe uljet e blerjeve. Zbritjet në blerje.
- ▶ Shitjet e mallit dhe kontabiliteti i tyre. Kthimet dhe uljet e shitjeve. Zbitjet në shitje.

9. Inventarizimi i mallrave dhe kostoja e shitjes.

- ▶ Inventari i mallrave dhe vlersimi i gjendjes së mallrave;
- ▶ Kostoja e blerjes së mallrave dhe metodat e vlerësimit të mallrave me kosto (FIFO, Mesatare);

10. Pasuria afatshkurtër dhe afatgjatë.

- ▶ Kuptimi dhe karakteristikat e përgjithshme të pasurisë afatshkurtër;
- ▶ Klasifikimi i pasurisë afatshkurtër;
- ▶ Kuptimi dhe klasifikimi i pasurisë afatgjatë;
- ▶ Regjistrimi kontabël i pasurisë afatgjatë;
- ▶ Zhvlerësimi (depreciation), amortizimi (amortization) dhe harxhimi (depletion) i pasurisë afatgjatë;

11. Kontabiliteti i detyrimeve dhe kapitalit.

- ▶ Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata (klasifikimi i tyre);
- ▶ Kapitali dhe burimet e tij;

12. Llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve.

- ▶ Evidentimi i të ardhurave dhe regjistrimi i tyre;
- ▶ Klasifikimi i shpenzimeve dhe njohja e tyre në kontabilitet;

13. Kollokiumi i dytë

- ▶ Vetëm DETYRA

14. Prezentim dhe demonstrim i software-it të kontabilitetit. (RIKONT)

- ▶ Software - RIKONT

15. Përmbledhje e ligjeratave, ushtrimeve dhe detyrave.